



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve  
Centralna Izborna Komisija  
Central Election Commission



Prishtinë/Priština, rr./ul. Agim Ramadani tel. +381 (0) 38 551 679; kqz.sekretariati@kqz-ks.org; www.kqz-ks.org

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve,

Në bazë të autoritetit të dhënë me nenin 74 të Ligjit nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datë 29.10.2009 nxjerr këtë:

**V E N D I M**

**Për pagesat e anëtarëve të Këshillave të Vendvotimeve (KVV)**

1. KQZ-ja përmes kësaj vendos për pagesën e Këshillave të Vendvotimeve (KVV) dhe Stafit tjetër ndihmës për Zgjedhjet Komunale në Republikën e Kosovës me 15 nëntor 2009 si në vijim:
  - a) Tridhjetë e gjashtë EURO e njëzet e gjashtë Cent (36.26)€ në ditë çdo Kryesuesi të Këshillit të Vendvotimit (KVV). Kryesuesit duhet të paguhen për një periudhë kohore prej tri (3) ditësh;
  - b) Njëzetë e katër EURO e pesëdhjetë e gjashtë Cent (24.56)€ në ditë çdo anëtarë të KVV-së. Anëtarët e KVV-së duhet të paguhen për një periudhë kohore prej tri (3) ditësh;
  - c) Tetëmbëdhjetë EURO e shtatëdhjetë e një Cent (18.71) € në ditë çdo anëtarë rezervë të KVV-së, për një periudhë kohore prej dy (2) ditësh;
  - d) Tetëmbëdhjetë EURO e shtatëdhjetë e një Cent (18.71) € në ditë çdo zyrtar të tavolinës ndihmëse në qendrat e votimit, për një periudhë kohore prej dy (2) ditësh;
  - e) Njëzet e nëntë EURO e njëzet e katër cent (29.24)€ në ditë çdo Menaxheri të Qendrave të Votimit (QV). Menaxherët e QV-ve duhet të paguhen për një periudhë kohore prej dy (2) ditësh;
  - f) Tetëmbëdhjetë EURO e shtatëdhjetë e një Cent (18.71) € në ditë për çdo Kontrollues të radhës. Kontrolluesit e radhës duhet të paguhen për një periudhë kohore prej dy (2) ditësh;
  - g) Pesëdhjetë EURO (50)€ në ditë për çdo Pronar të Kombibusit për transportimin e materialit sensitiv zgjedhor;
  - h) Shtatëmbëdhjetë EURO e pesëdhjetë e katër cent (17.54)€ në ditë për çdo Punëtor Fizik për ngarkimin dhe shkarkimin e materialit zgjedhor.
2. Pagesat për të gjitha kategoritë e sipër permendura janë llogaritur në Bruto,
3. Obligohet KE i SKQZ-së që të ndërmarrë veprimet e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi
4. Ky Vendim hyn në fuqi me 29.10.2009 dhe shfuqizon vendimin e datës 14.09.2009 për pagesat e anëtarëve të KVV-ve.

**Nesrin Lushta**

Kryetare e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve